



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 43/ Prot.
21

Tiranë, më 27.02.2025

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2024.

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2024 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHETIT

HYRJE

Për vitin 2024, performanca e realizimit të buxhetit, për Kontrollin e Lartë të Shtetit është mbështetur në Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”

Monitorimi i treguesve buxhetore, kryhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar më qëllim realizimin e objektivave të synuara dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2024-2026 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe reformave në kuadër të anëtarësimit në BE.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2024”

Buxheti i akorduar me Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, për vitin 2024, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në vlerën për **684,000 mijë lekë** ndahet sipas zërave të poshtëm:

- Shpenzime për Paga dhe Sigurime në vlerën për 598,100 mijë lekë
- Shpenzime për mallra dhe Shërbime në vlerën për 70,900 mijë lekë
- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë

Ky buxhet është shtuar në zërin 606 “Ndihmë Financiare” në vlerën për 1,500 mijë lekë si dhe KLSH, ka trashëguar nga viti 2023 Grandin Kapital me Financim të Huaj, në vlerën për 3,181 mijë lekë (kapitulli 06). Bazuar në nevojat për mjete financiare plani vjetor i buxhetit

është rishpërndarë brënda zërave të shpenzimeve korente dhe kapitale. Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2024.

Në mijë lekë


Kap	Art	Kod Projekti	Kod Projekti	Fakti 2023	Ligji i Buxhetit Viti 2024	AN. Nr.5 19.12.2024	Fakti 2024	Diferenca	%
1	600	92401AA	Paga	402,587	531,300	466,300	456,121	10,179	97.80%
1	601	92401AA	Sigurime	62,524	66,800	71,800	69,813	1,987	97.20%
	600+601	Paga dhe Sigurime		465,111	598,100	538,100	525,934	12,166	97.70%
1	602	92401AA	Mallra dhe shërbime	71,424	70,500	75,500	71,082	4,418	94.10%
1	605	92401AA	Transferta me jashtë	116	400	400	292	108	73.00%
1	606	92401AA	Ndihma	643	1,500	1,500	1,151	349	76.70%
	602-606	Mallra dhe Shërbime		72,183	72,400	77,400	72,525	4,875	93.70%
1	231	M240009	Pajisje informatike	2,229	4,200	4,200	0	4,200	0.00%
1	231	M240002	Mjete transporti	0	5,200	5,200	4,920	280	94.60%
1	231	M240003	Rikonstruksion ndërtesa	634	1,600	0	0	0	0.00%
1	231	M240010	pajisje Zyre	3,191	2,000	1,530	1,522	8	99.50%
3	230	19AA402	Kosto Lokale	0	1,000	2,250	2,190	60	97.40%
4	230	M24008	TVSH	1,817	1,000	1,820	1,817	3	99.80%
	231	Investime me Fin. te Brendshëm		7,870	15,000	15,000	10,450	4,550	69.7%
6	231/6	Grand i Huaj				3,181	2,908	273	91.40%
2	230	Financim i Huaj (Projekti SECO)					4,129	0	100%
		Totali I Përgjithshëm		545,164	685,500	630,500	615,946	21,865	97.60%

Shpenzimet buxhetore të planifikuara për vitin 2024 në vlerën totale për 637,811 mijë lekë (përfshirë Financimi i Huaj në vlerën për 7,311 mijë lekë nga i cili: Grand i huaj i trashëguar nga viti 2023 në vlerën për 3,181 mijë lekë dhe grand i huaj nga SECO në vitin 2024 në vlerën për 4,129 mijë lekë), janë realizuar në vlerën për 615,946 mijë lekë ose në masën për 98 %.

Realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 97,7 %
- Shpenzimet e tjera operative 93,7 %
- Shpenzimet kapitale të Brendshme 69,7 %
- Financimi i Huaj 100 %.

Paraqitja grafike e realizimit të buxhetit 2024 në lekë.



ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR VITIN 2024

1. Shpenzime Personeli. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në zbatim të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar me akte normative, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 538,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve të KLSH-së për vitin 2024 është 243 punonjës. Për vitin 2024, buxheti i planifikuar në vlerën për 538,100 mijë lekë është realizuar në vlerën për 525,934 mijë lekë ose realizuar në masën 97,7%.

Shuma e shpenzuar në zërin “Shpenzime Personeli”, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform kontratave të nënshkruara me ta.

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024, në zbatim të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar me akte normative, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për **75,500 mijë lekë**, ose 12 % e planit buxhetor të vitit 2024. Ky zë, është realizuar në vlerën për **71,082 mijë lekë** ose është realizuar në **masën 94 %**.


Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar nevojat administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, energjia elektrike, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim, dieta dhe hotel brenda vendit në vlerën për 40,380 mijë lekë dhe përfaqësojnë 57% të shpenzimeve faktike të këtij zëri.

Aktualisht, për vitin 2024, KLSH, ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Rinovim suporti të licenca të Firewall dhe E-Mail Security. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, mirëmbajtje sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, shërbim dhe pjesë këmbimi automjete, etj.

Paraqitja grafike e shpenzimeve për “Mallra dhe Shërbime”.



2.1 Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2024, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 292 mijë lekë nga 400 mijë lekë të planifikuara.

3. Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2024, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën **1,500 mijë lekë**, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie, sëmundjeje si dhe dhënien e ndihmës financiare punonjësve mbështetës organikë në mbyllje të vitit ushtrimor. Ky fond, është realizuar në vlerën për **1,151 mijë lekë**, ose është realizuar në masën për 77% të buxhetit vjetor të planifikuar.

4. Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, fondi i miratuar për Shpenzime Kapitale është vetëm për investime Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë. Këtij fondi i është shtuar edhe vlera për 3,181 mijë lekë trashëguar nga viti 2023 nga grand i huaj në kapitullin 06. Detajimi dhe rishpërndarja e fondeve buxhetore të miratuara në këtë zë, është kryer duke mbajtur në vëmendje nevojat për shpenzime kompjuterike, rikonstruksion ndertesa, kostot lokale dhe tvsh për projektin me financim të huaj si dhe nevojat për paisje zyre.

4.1-Financim i Brendshëm.

Tabela në vijim paraqet planifikimin e investimeve kapitale me **Financim të Brendshëm**.

Art	Kod Projekti	Kod Projekti	Ligji I Buxhetit	AN. Nr.5 19.12.2024	Fakti 2024	Diferenca	%
231	M240009	Paisje informatike	4,200	4,200		4,200	0.0%
231	M240002	Mjete transporti	5,200	5,200	4,920	280	94.6%
231	M240003	Rikonstruksion ndertesa	1,600	0		0	0.0%
231	M240010	Paisje Zyre	2,000	1,530	1,522	8	100%
230	19AA402	Kosto Lokale	1,000	2,250	2,190	59,587	97.4%
230	M24008	TVSH	1,000	1,820	1,817	3,300	99.8%
231	Investime me Financim te Brendshem		15,000	15,000	10,450	4,550	69,7%

Në buxhetin e vitit 2024, fondet e miratuara në zërin 231 “**Pajisje Zyre**” me kod projekti M240010, janë në vlerën për 1,530 mijë lekë. Bëjmë me dije se, KLSH, ka realizuar kontratën në vlerën për **4,431 mijë lekë** nga të cilat vlera për 1,523 mijë lekë janë nga kapitulli 01, buxheti i shtetit dhe vlera për 2,908 mijë lekë nga kapitulli 06, grand i huaj i trashëguar nga viti 2023. Ky projekt investimi konsiston në rimodelimin e sallës së mbledhjeve të KLSH-së si dhe në blerjen e pajisjeve të reja. Adresimi i fondeve të investimeve në këtë projekt investimi ka ardhur si domosdoshmëri, pasi salla ekzistuese e mbledhjeve nuk i përmbushte kërkesat e një standardi të punës dhe prezantimin dinjitoz si institucion suprem auditimi, që të jetë në nivelin e kërkesave të kohës, kjo pasi pjesa më e madhe e pajisjeve ekzistuese ishin të amortizuara.

Plani i buxhetit në zërin “**Blerje automjeti**”, në vlerën për **5,200,000 lekë** është realizuar në vlerën për **4,920 mijë lekë**

Plani i buxhetit në zërin “**Kosto lokale**” në vlerën për **2,250 mijë lekë** i përket shpenzimeve për projektin e investimit “**Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri**”. Për vitin 2024, ky zë është realizuar në masën për **2,190 mijë lekë** ose në masën për 97,4%.

Plani i buxhetit në zërin “TVSH”, në vlerën për **1,820 mijë lekë** dhe që i përket shpenzimeve për projektin e investimit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Për vitin 2024, ky zë është realizuar në masën për **1,816 mijë lekë** ose 100 %.

Në zërin “**Pajisje informatike**”, KLSH, ka prokuruar fondet për blerjen e pajisjeve informatike kompjuterike, në funksion të veprimtarisë audituese. Për vitin 2024, ky zë i planifikuar në vlerën për 4,200 mijë lekë nuk është realizuar nga AKSHI.

4.2-Financim i Huaj.

Bazuar në Ligjin nr. 97/2023,, “Për buxhetin e vitit 2024”, nuk ka patur një plan buxheti me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 230 për zbatimin e projektit “**Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri**”, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO)

Projekti “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” në vlerën totale për 21,800 mijë lekë, bashkëfinancim u zyrtarizua me firmosen e Marrëveshjes nr. 307, datë 09.03.2020 mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky projekt kishte për qëllim forcimin e llogaridhënies gjatë përdorimit të fondeve publike nëpërmjet promovimit të mbikëqyrjes dhe shmangies së korrupsionit në hartimin dhe implementimin e kontratave të koncesioneve dhe të PPP-ve në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij projekti, KLSH realizoi me sukses produktet dhe aktivitetet e parashikuara në Marrëveshje, si më poshtë:

1.Kryerjen e 3 auditimeve pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, të mbështetura në të gjitha fazat e auditimit nga eksperti i jashtëm i kontraktuar si pjesë e projektit.

KLSH auditori kontratat koncesionare si vijon:

(i)“Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”

(ii)“Dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”.

(iii)Marrëveshjet hidrokarbure.

Gjithashtu u bë e mundur:

-Hartimi i “Manualit për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve”, i cili reflekton eksperiencën e fituar përgjatë kryerjes së 3 auditimeve pilot, shoqëruar me trajnimet e nevojshme

-Vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive, me qëllim shkëmbimin e njohurive në fushën e koncesioneve, ku morën pjesë rreth 20 auditues të KLSH-së.

-Në organizimin e aktivitetit përmbyllës të gjithë kësaj pune gati 4-vjeçare, morën pjesë auditues, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri dhe të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO). Në këtë takim u prezantuan rezultatet e projektit.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PËR VITIN 2024.

KLSH përgjatë vitit 2024 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat:

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

A-Treguesit kryesore të veprimtarisë audituese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2024, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me Vendimin nr. 210, datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH, duke kryer **155 misione auditimi**, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Përgjatë kësaj periudhe, janë kryer auditime financiare, përputhshmërie, të kombinuar, performance si dhe auditime IT. Në periudhën 2024, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri

aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti a mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2024, ka përfunduar kryerjen e 155 auditimeve, duke dhënë opinione të pamodifikuara (Financiare & Përputhshmërie), opinione të modifikuara (Financiare & Përputhshmërie) si dhe konkluzione për çështje të veçanta

Gjatë vitit 2024, KLSH ka adresuar rekomandime për masa organizative dhe propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

Janë dhënë rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, të ndara sipas zërave në: dëmi ekonomik, menaxhimi jo efektiv i fondeve, mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor.

Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara masa disiplinore dhe administrative,

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe kodit të punës.

Gjithashtu, bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara masa administrative si dhe u ka kërkuar organit respektiv Agjencisë së Prokurimit Publik, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative.

Nga rezultatet e auditimeve, gjatë kësaj periudhe, gjetjet e konstatuara i referohen:

Parregullsi dhe mangësi në zbatimin e disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e shpenzimeve përfshirë dhe ato për investime, krijimin e detyrimeve të prapambetura etj.;

Përdorimit të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë kryesisht në fushën e prokurimit publik, për shkak të mangësi në realizimin e procedurave të cilat në shumë raste rezultojnë se nuk kryhen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;

B- Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, u trajnuan gjithsej 177 auditues duke realizuar mesatarisht 26 ditë trajnimi/vit për auditues. Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë vitit 2024, rendisim: tema që prekin çështjet mjedisore (si industria nxjerrëse, burimet ujore), tema mbi çështje të integritetit, forcimi i kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve, siguria e informacionit dhe krimi kibernetik dhe përmirësimi i aksesit me standarde të larta në shërbimet publike nëpërmjet GovTech., të shkruarit e raporteve, menaxhimi i cilësisë së auditimit, mbi manualin e auditimit

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për vitin 2024, jepet në Buletinin Statistikor për vitin 2024, të publikuar në faqen web të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



Titri i Grupit/Kontrollit/Lartë i Shtetit		Kodi i grupit										24	Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit			
Emërtimi	Emërtimi	Viti pararendës 2023		Periudha raportuese		Struktura e shpenzimeve		Periudha raportuese		Ndryshimi i planit vjetor		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)		% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit			
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)
Shpenzimet sipas programeve buxhetore																
01120	Vepimaria Audituese e KLSH	552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	630,500,000.00	100	-53,500,000.00	613,038,159.50	100	17,461,840.50	97				
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kep 01,02,03,04,05,06,22)		552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	630,500,000.00	100	-53,500,000.00	613,038,159.50	100	17,461,840.50	97				
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kep 06)																
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		552,481,200.90	0.00	684,000,000.00	0.00	630,500,000.00	0.00	-53,500,000.00	613,038,159.50	0.00	17,461,840.50	97				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik																
Emërtimi																
600	Paga	402,596,593.00	73	531,300,000.00	78	466,300,000.00	74	-65,000,000.00	456,120,688.00	74	10,179,312.00	98				
601	Squmime Shoqërore	62,524,010.00	11	66,800,000.00	10	71,800,000.00	11	5,000,000.00	69,813,026.00	11	1,986,974.00	97				
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	71,423,959.90	13	70,900,000.00	10	75,500,000.00	12	4,600,000.00	71,082,161.50	12	4,417,838.50	94				
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0				
604	Transferëta Korrente të Brendshme	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0				
605	Transferëta Korrente të Huaja	116,035.00	0	0.00	0	400,000.00	0	400,000.00	292,166.00	0	107,834.00	73				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	643,117.00	0	0.00	0	1,500,000.00	0	1,500,000.00	1,150,880.00	0	349,120.00	77				
Non-Totali Shpenzime Korrente		537,293,704.90	97	669,000,000.00	98	615,500,000.00	98	-53,500,000.00	598,456,921.50	98	17,044,078.50	97				
230	Kapitale të Përpëzuara	1,816,700.00	0	0.00	0	4,070,000.00	1	4,070,000.00	4,007,113.00	1	62,887.00	98				
231	Kapitale të Trupëzuara	6,053,455.00	1	15,000,000.00	2	10,930,000.00	2	-4,070,000.00	6,442,475.00	1	4,487,525.00	59				
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		7,870,155.00	1	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	10,449,588.00	2	4,550,412.00	70				
230	Kapitale të Përpëzuara	7,317,340.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	4,129,650.00	1	-4,129,650.00	0				
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0				
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		7,317,340.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	4,129,650.00	1	-4,129,650.00	0				
Totali Shpenzime Kapitale		15,187,495.00	3	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	14,579,238.00	2	420,762.00	97				
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	630,500,000.00	100	-53,500,000.00	613,038,159.50	100	17,461,840.50	97				
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kep 06)																
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga të ardh. jashtë limitit)		552,481,200.90	0.00	684,000,000.00	0.00	630,500,000.00	0.00	-53,500,000.00	613,038,159.50	0.00	17,461,840.50	97				
Numri i punonjësve		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0				



Emri: Valbona Gërxhaj
 Firma: [Signature]
 Data: 17.02.2025

Sekretari i Përgjithshëm

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2024

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese /Vjetore	Buxheti	Artikujt buxhetore						Total	
					230	231	600	601	602	605		606
24	01	Nga Buxheti	2024	Plani fillestar	0	13,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	682,000,000
24	01	Nga Buxheti	2024	Plani i rishikuar	0	10,930,000	466,300,000	71,800,000	75,500,000	400,000	1,500,000	626,430,000
24	01	Nga Buxheti	2024	Fakti	0	6,442,475	456,120,688	69,813,026	71,082,162	292,166	1,150,880	604,901,397
24	01	Nga Buxheti	2024	Angazhime	0	180	0	0	855,187	0	0	855,367
24	02	Financim i huaj - Grant	2024	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0
24	02	Financim i huaj - Grant	2024	Plani i rishikuar	0	0	0	0	0	0	0	0
24	02	Financim i huaj - Grant	2024	Fakti	4,129,650	0	0	0	0	0	0	4,129,650
24	02	Financim i huaj - Grant	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0
24	03	Kosto lokale	2024	Plani fillestar	0	2,000,000	0	0	0	0	0	2,000,000
24	03	Kosto lokale	2024	Plani i rishikuar	2,250,000	0	0	0	0	0	0	2,250,000
24	03	Kosto lokale	2024	Fakti	2,190,413	0	0	0	0	0	0	2,190,413
24	03	Kosto lokale	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	2024	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	2024	Plani i rishikuar	1,620,000	0	0	0	0	0	0	1,620,000
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	2024	Fakti	1,816,700	0	0	0	0	0	0	1,816,700
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0
24		Total	2024	Plani fillestar	0	15,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	684,000,000
24		Total	2024	Plani i rishikuar	4,070,000	10,930,000	466,300,000	71,800,000	75,500,000	400,000	1,500,000	630,500,000
24		Total	2024	Fakti	8,136,763	6,442,475	456,120,688	69,813,026	71,082,162	292,166	1,150,880	613,038,160
24		Total	2024	Angazhime	0	180	0	0	855,187	0	0	855,367
24		Ndryshimi ne vler absolute	2024		-4,066,763	4,487,525	10,179,312	1,986,974	4,417,839	107,834	349,120	17,461,841
24		Realizimi ne %	2024		200	59	98	97	94	73	77	97
24	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2024	Fakti	0	2,908,165	0	0	0	0	0	2,908,165
24	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0



Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Emri: *Valbona Çajupaj*
 Firma: *Çajupaj*
 Data: *27.02.2025*

Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 12-2024

Kodi i Ministris	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	Total
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Plani fillestar	0	15,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	684,000,000
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Plani i rishikuar	4,070,000	10,930,000	466,300,000	71,800,000	75,500,000	400,000	1,500,000	630,500,000
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Shpenzime faktike	8,136,763	6,442,475	456,120,688	69,813,026	71,082,162	292,166	1,150,880	613,038,160
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Angazhime	0	180	0	0	855,187	0	0	855,367
24		Ndryshimi ne vlere absolute	2024		-4,066,763	4,487,525	10,179,312	1,986,974	4,417,839	107,834	349,120	17,461,841
24		Realizimi ne %	2024		200	59	98	97	94	73	77	97
24		Te ardhura jashte limiti	2024		0	2,908,165	0	0	0	0	0	2,908,165
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Shpenzime faktike	0	15,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	684,000,000
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Plani fillestar	4,070,000	10,930,000	466,300,000	71,800,000	75,500,000	400,000	1,500,000	630,500,000
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Plani i rishikuar	8,136,763	6,442,475	456,120,688	69,813,026	71,082,162	292,166	1,150,880	613,038,160
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Shpenzime faktike	0	180	0	0	855,187	0	0	855,367
24		Numri i punonjese ne Total	2024	Angazhime								0
24		Numri i punonjese ne Total	2024	Plani fillestar								0
24		Numri i punonjese ne Total	2024	Plani i rishikuar								0
24		Numri i punonjese ne Total	2024	Numri faktik								0

Emri	Emri	Emri
Firma	Firma	Firma
Data	Data	Data
Drejtoesi i Ekipit Menaxhues te Programit		Sekretari i Përgjithshëm
Emri: <i>Valbona Bardha</i> Firma: <i>[Firma]</i> Data: <i>27.02.2025</i>		Emri: <i>[Emri]</i> Firma: <i>[Firma]</i> Data: <i>[Data]</i>



Emri i Gr. Kontrolli, Lartë i Shtetit		Kodi i grupit										24		
Emri i		Kodi i programit										01120		
Vepërimitaria Audituese e KLSH		Shpenzimet e Programit												
Kodi i Programit	Emërtimi	Viti pararendës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Struktura e shpenzimeve në %	Kryeshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillester Vjetor VII 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar VII 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndëryshimi i planit Vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Prognoze	Struktura e shpenzimeve në %	10 (8-8)			
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (8-5))	(8)	(9)				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik														
Emërtimi														
